



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 16.11.2021

Drejtuar: Operatorit Ekonomik **“TRIOS-SH.A” shpk** me NUIS L12805203J me adresë Rruga Dibres,462/2, pranë xhamisë Xhura,porcelan,kati i dytë.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-09089-10-21-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje lëndë djegëse për përdorim termik, civil dhe industrial”, me fond limit 26.250.140 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 154, datë 25 tetor 2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Operatori ekonomik **“RESULI-ER” sh.a** me NUIS L12510413V me adresë Fier Qender, me ofertë ekonomike 47% (dyzet e shtatë) lekë pa tvsh

2.Operatori ekonomik **“TRIOS” sha** me NUIS L12805203J me adresë Rruga Dibres, dhe me ofertë ekonomike 25.769.602 (njëzet e pesë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dy) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“RESULI-ER” sh.a** me NUIS L12510413V

Për arsyet e mëposhtme:

“RESULI-ER” sh.a

- “Nuk përmbush pikën 1, shkronja b, të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku është parashikuar se *"Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:...b. Sigurimin e ofertës, sipas Shtojcës 3..."*, pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.
- Nuk përmbush shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” dhe shtojcën 2 “Lista e Çmimeve të Artikujve” të DST-së pasi operatori ka ofertuar me marzh fitimi dhe jo me çmim për njësi.
- Nuk përmbush pikën 2.1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: *Çertifikatë ISO 9001-2015 (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)*,pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.1.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: *Çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)*, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018,2019,2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit*, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “TRIOS” sh.a me NUIS L12805203J me adresë Rruga Dibres,462/2, prane xhamisë Xhura,porcelan,kati i dyte,Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 25.769.602 (njëzet e pesë milion e shtatëqind e gjashtëdhjet e nëntë mijë e gjashtëqind e dy) lekë pa tvsh, është identifikuar si Oferte e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.